

Latest legal news

Albania and Kosovo

December 2021



pwc

Albania - Draft law “On e-government”

On 22.10.2021 the draft law on e-government was published for public consultation.

This draft law is a novelty of the Albanian legislation since so far online services in Albania have not been regulated through a specific law. This draft law is also in line with Article 103 of the Stabilization and Association Agreement, European principles, and the principle of fair and free competition.

This draft law aims to define the rights, obligations and responsibilities of public authorities and private entities in respecting electronic security standards, defining rules for the establishment and provision of e-government services in the Republic of Albania and the access, processing and recording of information electronically.

The authority responsible for Electronic Certification and Cyber Security for public services will be NITA - National Information Technology Agency, which will serve as the creator and administrator of the service infrastructures, systems, portals, trusted services, and registers, as certifiers and cyber security monitor, as well as contributing to the drafting of policies and action plans in the field of ICT.

Meanwhile, the government interaction platform for providing e-government services will be e-Albania. In this platform every citizen can log in through the ID and password set by the person himself. In the draft law, such a way of identification is introduced with the concept of Single sign on - the unique scheme of user identification.

The provision of e-government services in the territory of the Republic of Albania by public authorities and private entities, according to this draft law, is guided by the principle of security, legality, and the principle of protection of the public interest.

The most important innovation of this law is related to the creation of a joint stock company "DgTech", for the provision of services in the field of Technology and Information to individuals and legal entities, public authorities, and private entities. This company is established and operates according to the provisions of the law "On traders and companies", as amended and monitored and supervised by NITA. Private entities operating in the field of information technology may own shares but not more than 49 (forty-nine) % of the total number of shares.

Finally, this law provides favorable provisions for foreigners, through the e-residence system, which is the ICT system, which enables foreign nationals to apply for virtual residence in the Republic of Albania, gain the right to open a business in the Republic of Albania without the need for physical presence.

Source: [link](#)

Më 22.10.2021 është publikuar për konsultim publik projektligji për qeverisjen elektronike.

Ky projektligj është një risi në legjislacionin shqiptar duke qenë se deri më tani në Shqipëri shërbimet online nuk kanë qenë të rregulluara nëpërmjet një ligji të caktuar. Ky projektligj është gjithashtu në përputhje me Nenin 103 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, parimet Evropiane dhe parimin e konkurrencës së drejtë dhe të lirë.

Ky projektligj synon të përcaktojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike dhe subjekteve private në respektimin e standarteve të sigurisë elektronike, përcaktimin e rregullave për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike në Republikën e Shqipërisë si dhe aksesin, përpunimin dhe protokollimin e informacionit në rrugë elektronike.

Autoriteti përgjegjës për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për shërbimet publike do të jetë AKTI - Agjencia Kombëtare e Teknologjisë së Informacionit, i cili do të shërbejë si krijues dhe administrues i infrastrukturave të shërbimeve, sistemeve, portaleve, shërbimeve të besuara dhe regjistrave, si çertifikues dhe monitorues i sigurisë kibernetike, si dhe si kontribues në hartimin e politikave dhe planeve të veprimit në fushën TIK.

Ndërkohë, platforma qeveritare e ndërveprimit për ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike do të jetë e-Albania. Në këtë platformë çdo qytetar mund të logohet nëpërmjet ID- së dhe fjalëkalimit të caktuar nga vetë personi. Në projektligj, një mënyrë e tillë identifikimi njihet me konceptin e *Single sign on* - skema unike e identifikimit të përdoruesve.

Ofrimi i shërbimeve të qeverisjes elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë nga autoritetet publike dhe subjektet private, sipas këtij projektligji, udhëhiqet nga parimi i sigurisë, ligjshmërisë dhe parimi i mbrojtjes së interesit të publikut.

Risia më e madhe e këtij ligji ka të bëjë me krijimin e një shoqërie aksionare "DgTech", për ofrimin e shërbimeve në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit ndaj personave fizikë dhe juridikë, autoriteteve publike dhe subjekteve private. Kjo shoqëri, krijohet dhe funksionon sipas parashikimeve të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe monitorohet e mbikëqyret nga AKTI. Subjektet private që ushtrojnë aktivitet në fushën e teknologjisë së informacionit mund të zotërojnë aksione por jo më shumë se 49 (dyzetë e nëntë) % të numrit total të aksioneve.

Së fundmi, ky ligj parashikon dispozita favorizuese edhe për të huajt, nëpërmjet sistemit e-rezidenca që është sistemi TIK, që i mundëson shtetasve të huaj të aplikojnë për rezidencë virtuale në RSH, për të përfituar të drejtën e hapjes së një biznesi në RSH pa qenë nevoja e paraqitjes fizike.

Burimi: [link](#)

Kosovo - Draft Law on the Protection of Trade Secrets

On 26.11.2021, Kosovo's Government has approved the draft law on the Protection of Trade Secrets (hereinafter the "Law").

Based on the need for institutional establishment in order to protect trade secrets in the domestic and foreign market, the elimination of potential barriers, ensuring consumer protection, and the development of the Industrial Property Area of Kosovo in accordance with all relevant international requirements, the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade, respectively the Industrial Property Agency has proposed the issuance of the Law on Protection of Trade Secrets.

The law on the protection of trade secrets which will be in line with EU legal acts as (EU) Directive 2016/943 of the European Parliament of 8 June 2016 on the protection of undisclosed know-how and business information (trade secrets) against their unlawful acquisition, use and disclosure (OJ L157, p. 1, 15.6.2016).

This draft law is one of the priorities of the Government of Kosovo, because this legal act will be regulated, protected, and implemented in the benefit and good of the public interest. Therefore, the Government of Kosovo has decided that this legal act is one of the priority laws to be changed and it is included in the Government Legislative Program for 2021.

Based on this law a trade secret will be considered the information which meets all of the following requirements: (i) it is secret in the sense that it is not, as a body or in the precise configuration and assembly of its components, generally or readily accessible to persons within the circles that normally deal with the kind of information in question; (ii) it has commercial value because it is secret; (iii) it has been subject to reasonable steps under the circumstances, by the person lawfully in control of the information, to keep it secret.

This law will also regulate the cases when the acquisition of the trade secret will not cause violation of the provisions of the law. Acquisition of trade secret is considered lawful when trade secret is obtained in any of the following ways: (i) independent discovery or creation; (ii) observation, study, disassembly or testing of a product or object that has been made available to the public or that is lawfully in the possession of the acquirer of the information who is free from any legally valid duty to limit the acquisition of the trade secret; (iii) exercise of the right of workers or workers' representatives to information and consultation in accordance with Union Law and national laws and practices; (iv) any other practice which, under the circumstances, is in conformity with honest commercial practices..

Measures, procedures, and remedies against the unlawful acquisition, use and disclosure of trade secret will be initiated before the competent court. The right to demand for damages and legal actions for the measures, procedures and lawsuits provided for violation of trade secrets terminates when the six-year (6) term expires from the moment when the holder of trade secret is informed of the violation or damages and related to the person responsible for compensation.

This law will also regulate the penalties that will be imposed to the persons who violate provisions of this law regarding the trade secrets. The penalties will include fines that will vary from EUR 500 to EUR 15.000.

Source: [link](#)

Më 26.11.2021, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare (në tekstin e mëtejshëm "Ligji").

Bazuar në nevojën për ngritjen institucionale me qëllim të mbrojtjes së sekreteve tregtare në tregun vendor dhe të jashtëm, eliminimin e barrierave të mundshme, sigurimin e mbrojtjes së konsumatorit si dhe zhvillimin e sferës së pronësisë industriale të Kosovës në përputhje me të gjitha kërkesat relevante ndërkombëtare, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Agjencia për Pronësi Industriale ka propozuar nxjerrjen e Ligjit për Mbrojtjen e Sekreteve Tregtare.

Ligji për mbrojtjen e sekreteve tregtare do të jetë në përputhje me aktet ligjore të BE-së, si Direktiva (BE) 2016/943 e Parlamentit Evropian e datës 8 qershor 2016 mbi mbrojtjen e njohurive të pazbuluara dhe informacionit të biznesit (sekretet tregtare) kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të tyre (OJ L157, f. 1, 15.6.2016).

Ky projektligj është një nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës, sepse ky akt ligjor do të rregullohet, mbrohet dhe zbatohet në dobi dhe të mirë të interesit publik. Prandaj, Qeveria e Kosovës ka vendosur që ky akt ligjor të jetë një nga ligjet prioritare për t'u miratuar dhe përfshihet në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2021.

Në bazë të këtij ligji, sekret tregtar do të konsiderohet informacioni i cili i plotëson të gjitha kërkesat e mëposhtme: (i) është një fshehtësi në kuptimin që, si trup ose konfigurim preciz dhe bashkim i përbërësve të tij, nuk është përgjithësisht ose lehtësisht i qasshëm për personat brenda qarqeve që zakonisht merren me llojin e informatës në fjalë; (ii) ka vlerë tregtare sepse është sekret; (iii) i është nënshtruar hapave të arsyeshëm sipas rrethanave, nga personi që në mënyrë të ligjshme e kontrollon informatën, për ta mbajtur atë sekret.

Ky ligj do të rregullojë edhe rastet kur marrja e sekretit tregtar nuk do të shkaktojë shkelje të dispozitave të ligjit. Marrja e Sekretit Tregtar konsiderohet i ligjshëm kur sekreti tregtar fitohet me ndonjë nga mënyrat e mëposhtme: (i) zbulimi ose krijimi i pavarur; (ii) Vrojtimi, studimi, ndarja ose testimi i një produkti ose objekti që është vënë në dispozicion për publikun ose që është në posedim të ligjshëm të marrësit të informacionit i cili është i lirë nga çdo detyrim i vlefshëm ligjor që të kufizojë marrjen e sekretit tregtar; (iii) ushtrimi i të drejtës së punëtorëve ose përfaqësuesve të punëtorëve për informim dhe konsultim në përputhje me ligjet dhe praktikat kombëtare; (iv) çdo praktikë tjetër, e cila, sipas rrethanave, është në përputhje me praktikat e ndershme tregtare.

Të gjitha masat, procedurat dhe mjetet juridike kundër fitimit, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të sekretit tregtar do të iniciohen para gjykatës kompetente. E drejta për të kërkuar dëmshpërblim dhe veprime juridike për masat, procedurat dhe paditë e parashikuara për shkeljen e sekretit tregtar parashkruhet kur skadon afati gjashtë vjeçar (6) nga momenti kur mbajtësi i sekretit tregtar është njoftuar për shkeljen ose dëmin dhe lidhur me personin përgjegjës për kompensimin.

Gjithashtu, me këtë ligj do të rregullohen edhe gjobat për ata që shkelin dispozitat e këtij ligji lidhur me sekretin tregtar. Këto gjoba do të fillojnë nga EUR 500 deri në EUR 15.000.

Burimi: [link](#)

Kosovo - Law on Electronic Identification and Trust Services in Electronic Transactions

On 06.12.2021, Kosovo Assembly has approved the law on Electronic Identification and Trust Services in Electronic Transactions (hereinafter the "Law").

This is a very important law by which will be regulated the following issues: (i) the identification method and electronic identification schemes (ii) the conditions on the use of electronic signature, electronic seal, electronic time stamp and equipment for creating them; (iii) Electronic registered delivery service for judicial proceedings (iv) conditions for issuing and using qualified certificates for service certification and website authentication; (v) trust services in electronic transactions and electronic documents.

This Law will fully in line with Regulation (EU) No. 910/2014 of the European Parliament and of the Council of 23 July 2014 on electronic identification and trust services for electronic transactions in the internal market and repealing Directive 1999/93/EC.

The supervisory authority, responsible for the implementation of the provisions of this law will be the Ministry of Information Technology and Communication in cooperation with the Information and Privacy Agency.

With the implementation of this law will be created easier opportunities in various transactions between businesses, individuals, etc.

The natural or legal persons or a natural person as a representative of a legal person will be identified by Electronic Identification. All legal and natural persons will be equipped with Digital Identity Portfolio ensuring trusted and uninterrupted access to public and private services inside and outside the country.

This law will also regulate electronic signature. The use of electronic signature will impact and will have many benefits. By using an electronic signature additional printing, scanning and mailing of paper will be avoid. Electronic signatures are typically used in PDF documents, such as contracts or orders.

According to this law a qualified electronic signature shall have the equivalent legal effect of a handwritten signature

The advanced electronic signature must: (i) be uniquely linked to the signatory; (ii) be capable of identifying the signatory; (iii) use data to create an electronic signature, which is under the sole control of the signatory; (iv) be linked to the data that it signs, in a way that would detect any subsequent change in them.

It is also worth mentioning that according to this law, the advanced electronic signature, based on an electronic certificate issued by each EU member state, will be recognized as an advanced electronic signature in Kosovo.

Electronic Seal is one of the issues that will be regulated by this law. The electronic seal will have the same legal value as the traditional seal. A qualified electronic seal shall be considered the advanced electronic seal created by a qualified device for electronic seal and is based on a qualified electronic certificate.

Further, this law will define the legal effects and admissibility of electronic documents as evidence in legal proceeding.

The three main benefits that this law will bring are (i) increased contract speed; (ii) enhanced security, and (iii) lower transaction costs.

Source: [link](#)

Me 06.12.2021, Kuvendi i Kosoves ka miratuar ligjin "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike" (këtu e tutje "Ligji").

Ky është një ligj shumë i rëndësishëm me të cilin do të rregullohen çështjet si në vijim: (i) mënyra e identifikimit dhe skemat e identifikimit elektronik; (ii) kushtet e përdorimit të nënshkrimit elektronik, vulës elektronike, vulës elektronike kohore dhe të pajisjeve për krijimin e tyre; (iii) shërbimet e regjistruara elektronike për procedurat gjyqësore; (iv) Kushtet e lëshimit dhe përdorimit të çertifikatave të kualifikuara për çertifikimin e shërbimeve dhe autentifikimin e faqes së internetit; (v) shërbimet e besuara në transaksionet elektronike dhe dokumentet elektronike.

Ky ligj do të jetë plotësisht në përputhje me Rregulloren (EU) Nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 Korrik 2014 mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm e cila e ka shfuqizuar Direktivën 1999/93/EC.

Autoriteti mbikëqyrës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji do të jetë Ministria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në bashkëpunim me Agjencinë e Informacionit dhe Privatësi.

Me zbatimin e këtij ligji do të krijohen mundësi më të lehta në transaksionet e ndryshme që do të krijohen ndërmjet bizneseve, individëve etj.

Personat fizikë ose juridikë ose një person fizik si përfaqësues i një personi juridik do të identifikohen me Identifikimin Elektronik. Të gjithë personat juridikë dhe fizikë do të pajisen me portofol të identitetit dixhital duke siguruar akses të besueshëm dhe të pandërprerë në shërbimet publike dhe private brenda dhe jashtë vendit.

Ky ligj do të rregullojë edhe nënshkrimin elektronik. Përdorimi i nënshkrimit elektronik do të ndikojë dhe do të ketë shumë përfitime. Duke përdorur një nënshkrim elektronik do të shmanget printimi shtesë, skanimi dhe postimi i letrës. Nënshkrimet elektronike zakonisht përdoren në dokumentet PDF, të tilla si kontrata ose porosi.

Në bazë të këtij ligji, një nënshkrim elektronik i kualifikuar do të ketë efektin juridik të barabartë me një nënshkrim të shkruar me dorë.

Një nënshkrim elektronik i avancuar duhet: (i) të jetë i lidhur në mënyrë unike me nënshkruesin; (ii) të jetë në gjendje të identifikojë nënshkruesin; (iii) të përdorë të dhënat për të krijuar një nënshkrim elektronik, i cili është nën kontrollin e vetëm të nënshkruesit; (iv) të jetë i lidhur me të dhënat që ai nënshkruan, në një mënyrë që do të zbulonte çdo ndryshim të mëvonshëm në to.

Gjithashtu vlen të ceket se sipas këtij ligji, nënshkrimi elektronik i avancuar, i bazuar në një certifikatë elektronike të lëshuar nga çdo shtet anëtar i BE-së, do të njihet si nënshkrim elektronik i avancuar edhe në Kosovë.

Vula Elektronike është gjithashtu një nga çështjet që do të rregullohet me këtë ligj. Vula elektronike do të ketë të njëjtën vlerë ligjore si vula tradicionale. Një vulë elektronike e kualifikuar do të konsiderohet vula elektronike e avancuar e krijuar nga një pajisje e kualifikuar për vulosje elektronike dhe bazohet në një certifikatë elektronike të kualifikuar.

Më tutje, ky ligj do të përcaktojë efektet juridike dhe pranueshmërinë e dokumenteve elektronike si provë në procedurat gjyqësore.

Tre përfitimet kryesore që do të sjellë ky ligj janë (i) rritja e shpejtësisë së lidhjes kontratave; (ii) siguri e shtuar, dhe (iii) kosto më të ulëta të transaksioneve.

Burimi: [link](#)



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1
Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700
Email: al_pwc_albania@pwc.com
Web: www.pwc.com/al

PricewaterhouseCoopers Kosovo
Str. Mujo Ulqinaku No. 5 Apt. 10, Qyteza
Pejton, Prishtina, Kosovo

Telephone: +383 38 722 555
Email: al_pwc_kosovo@pwc.com
Web: www.pwc.com/ks